



Trajneri i Skenderbeut Mirel Josa e dinte qe kjo ndeshje do te ishte nje sfide e forte dhe marrja e tre pikeve ishte objektivi. " Perpara takimit, u shpreha lojtareve te mij qe mos ta shihnim Tiranen si ekip te fundit ne tabelen e renditjes. Ata e kane rritur nivelin e lojes. Jane shume me mire nekrhasim me fazen e pare. Sot ishin ishin shume te ngjeshur ne mesfushe dhe na vune ne veshtersi. . Nuk u ndie mungesa e Orelesit sepse luajti Dimoo qe u paraqit shume mire. Ne humbem shume topa fale zgjidhjeve te gabuara qe u bene dhe pastaj ishim ne pozita te veshtira ne mbrojtje. Mua me pelqen te fitojme ndeshjet duke pare qe gjate javes kishim 6 lojtar me viroze dhe pikrisht ekipi humbi freskine . L

oja e Limanit na veshtirsoi shume dhe mund te pesonim gol me Coten por futbollli eshte i tille", u shpreh trajneri i Skenderbeut Mirel Josa icili vazhdon te ruaj respektin e tij per skuadren "bardh e blu".

"Une kam respekt per Tiranen sepse aty jam formuar dhe ate qe kam arrite deri ketu ja dedikoj Tiranës dhe i detyrohem shume, por une punoj per nje ekip tjeter qe e ka treguar vehten dhe ka nje organizim te shkelqyer. I uroj Tiranës me te miren, por tani punoj tek Korca. Nuk di te them pse Tirana eshte ne kete gjendje. Mendoj se ne krahasim me fillimin e kampionatit, skuadra ka bere shume permiresime dhe ka rekuperuar disa lojtaer shume te rendesishem pa harruar trajnerin qe kane marre", u shpreh Josa i cili e denoi plotesisht rremujen ne Stadium duke vleresuar vetem fitoren e skuadres se tij fale karakterit te treguar..

"Tensionin nuk e zhvilluan tifozat tone. Sharjet s'mund te ndalen. Nuk kam cfare te them per ngjarjet e dhunshme dhe trazirrat. Ka organe kompetente qe merren me kete pune. Per mua spektaktli eshte fitorja 1-0 ku tregohet karakteri i ekipit, perfundoi Josa prononcimin e tij per mediat pas ndeshjes.

## **Mirel Josa: Ndashje e veshtire, i kenaqur per fitoren**

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Dhjetor 2013 17:18

---